



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD

GJS-2022-012

Ushtruesja e detyrës së kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës - Mejreme Memaj, bazuar në nenin 4, 9 par. 1, nëpar. 1.2 dhe paragrafi 6, si dhe nenit 12 paragrafi 3 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, me 16.12.2022, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e F.J., –administratore në Gjykatën Themelore në Gjilan, për iniciimin e procedurës disiplinore kundër kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan.

A r s y e t i m

Administratorja e Gjykatës Themelore në Gjilan ka paraqitur ankesë ndaj kryetarit të gjykatës themelore në Gjilan V.S., të cilën ankesë ia ka drejtuar autoritetit jo kompetentë Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor.

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës konform nenit 9 par.2 të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve me 22 nëntor 2022 e ka transferuar ankesën tek Gjykata Supreme si autoritet kompetent sa i përket pretendimeve të shkeljeve disiplinore të Kryetareve të Gjykatave Themelore dhe Kryetarit të Gjykatës së Apelit (neni 9 par.1 nënpar.1.2 i ligjit të lartcekur).

Parashtruesja e ankesës pretendon se:

- pasi që V.S., është zgjedhur në pozitën e Kryetarit të Gjykatës, ai është hakmarrë ndaj ankueses duke e larguar nga zyra e saj, zyre e cila ka shërbyer për pozitën e administratores që nga viti 2013, hakmarrje kjo që buron që nga viti 2019 për shkak të lidhjes që sipas parashtrueses ai e kishte me një zyrtare të SMIL-it brenda gjykatës;

- pastaj i ka shqiptuar vërejtje pa arsye, pa bazë, për rastin e ndërmjetësuesve që ishte lajmëruar nga një ndërmjetësues, e që ankesa sipas parashtrueses nuk kishte të bënte me mos ftesën e ndërmjetësuesve sipas radhës por ishte bërë me qëllim hakmarrje ndaj saj dhe denigrim të integritetit të saj në çdo aspekt;

-me 17.06.2022 kryetari e kishte ftuar në zyrë e kishte akuzuar, kishte ushtruar dhunë psikike, frikësuar me tendencë për ta nënshtruar në raport me të, dhe krejt këtë e kishte bërë lidhur me notimin e performancës për vitin 2021 të asistentes F.A., të ish kryetarit të gjykatës R.A., të cilën kishte kërkuar që ish kryetari ta vlerësoj performancën e saj;

- sipas parashtrueses kryetari që nga koha kur e kishte marrë detyrën e tij vazhdimisht e ka kërkuar nga ajo dorëzimin e librit të AGJ-së në mënyrë jo ligjore duke i bërë kërkesë jo me shkrim por vetëm me urdhër verbal. Kurse, arsyeja e refuzimit nga ana e saj është se për vulën e protokollit dhe AGJ-në ka autorizim nga KGJ-ja dhe ka kërkuar nga ai që t'ia bënte kërkesën me shkrim, ndërsa ai ju ka drejtuar se “kush je ti me të bërë kërkesë me shkrim”.

-me 12.10.2022 kryetari i kishte shkuar në zyre kur punon e vetme rreth orës 13 30 dhe gjatë bisedës kishte filluar prapë me dhunë psikike, akuza, denigrim moral, kërcenim fizik e çka jo tjetër. Sipas ankueses në këtë bisedë kryetari presionin e vazhdon duke i thënë “ a e din që për ty flasin keq të gjithë si R.A., Sh.M., A.Z., etj”. Po ashtu gjatë kësaj bisedë kryetari e kishte paragjykuar edhe performancën ndaj saj duke i thënë se të tregoj në fund të vitit sepse t'i mendon se do të notoj si R., e kam me të notuar me dysh. Për tri orë kryetari kishte vjedhur zi e terr kundrejt saj duke e kërcënuar fizikisht, denigruar moralisht, dhunuar psikikisht, ngacmuar në çdo aspekt duke e fyer, paragjykuar dhe poshtëruar pa reshtur, dhe kjo mënyrë e sjelljes së tij prej psikopati është e papranueshme për të, jo ligjore, jo etike, jo njerëzore e turpshme sidomos kur behet fjalë për sulm ndaj koleges, ndaj një nenë, ndaj një gruaje;

- me 13.10.2022 në takimin e mëngjesit kryetari sipas parashtrueses e ka vazhduar dhunën psikike rreth dy ore në prezencë të nënkryetarit duke i thënë së nuk po punon asgjë. Kryetari dhe nënkryetari asnjëherë nuk kanë pas argument bindës se në çfarë aspekti nuk po punon mirë, dhe në bisedë e sipër kryetari i kishte bërtit si i çmendur duke e goditur tavolinën dhe thyer xhamin e saj me qëllim që ta frikësoj. Kjo sjellje sipas parashtrueses vjen si rezultat i një kërkesë të saj si administratore ndaj Sh.H.,- zyrtar i IT-së, e që në këtë kërkesë behet fjalë për vepër penale e që protagonist është V.S., i cili në vitin 2019 në cilësinë e gjyqtarit pas orarit të punës ka hyrë në mënyrë të pa autorizuar me dy zyrtarë të SMIL-it në departamentin e përgjithshëm divizioni penal ku kanë ndërhyrë në kompjuter dhe kanë fshirë dhjetëra lëndë. Për këtë rast e kishte njoftuar ish kryetarin R.A., dhe kishte obliguar Sh., që ta verifikoj këtë përmes kamerave, i cili verbalisht i kishte thënë pas kontrollimit të kamerave në departament se pas orarit të punës kishte hyrë V.S, Sh.D. e D.B., zyrtarë të SMIL-it dhe i kishte thënë se për të gjitha të tjerat e kishte informuar me shkrim ish kryetarin dhe për këtë çështje kishte menduar se ish kryetari do të iniciojë procedurë por e kishte heshtur këtë fakt dhe nuk e kishte njoftuar asgjë. Përveç kësaj edhe pas kontrollimit të auditorëve kishte hasur në një dokument vlera e të cilit kushtonte disa mijëra euro që ishte nënshkruar në emrin e saj nga ish kryetari R.A., pa dijeninë e saj për të cilën e kishte njoftuar verbalisht V.S., por i njëjti i kishte thënë “së nuk është asgjë”. Pas kërkesës së saj që Sh., t'ia dërgoj deklaratën me shkrim që ia kishte dërguar ish kryetarit ai nuk ia kishte dërguar ngase nuk e kishin lejuar, dhe pas kësaj kishte filluar përsëri dhuna psikike ndaj saj dhe kërcënimi;

- me 19.10.2022 kryetari e kishte ftuar ne zyre dhe e kishte marrë në pyetje duke abuzuar me detyrën zyrtare. Në këtë takim kryetari me nënkryetarin ushtronte dhunë psikike si në kohën e UDB-së jugosllave, dhe kjo ishte tentative me e fshehtë krimin që e kishte bërë vetë V., në vitin 2019. Madje Sh.H., e kishte akuzuar edhe për një vajzë praktikante se kinse kjo i kishte marr deklarata nën presion, e cila para dy muajsh i ishte ankuar në gjyqtarin që ishte duke e zhvilluar

praktikën se ai po e ngacmonte. Sipas parashtrueses këto ditë i është bërë presion edhe nga SKGJ-ja në lidhje me përkthyesen A.A..

Me qëllim të vërtetimit bazës së arsyeshme siç kërkohet me ligj, të këtyre pretendimeve e sipas detyrës zyrtare autoriteti kompetent ka kërkuar nga kryetari i Gjykatës Themelore në Gjiilan të deklarohen lidhur me këtë rast dhe ka pranuar deklaratën e të njëjtit se bashku me provat tjera që ia ka bashkëngjitur kërkesës si emaili-n e datës 30.06.2022; mendimin e dhënë për komisionin datë 17.12.2022; kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore Agj.nr.421/22 , procesverbalet e datave 15.09.2022 dhe 19.09.2022, deklaratën e dhënë nga R.A., R.S., M.Sh., V.D., L.S., ankesat e A.A., vendimin e komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave KA.nr.32/21 datë 27.07.2021, emaili-n e anëtarit të komisionit E.V., datë 19.10.2022, vendimin e KPMSHCK A.nr.681/22 datë 14.09.2022 për F. A..

Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjiilan V.S., në deklaratën e tij thekson se:

Asnjëra nga pretendimet e paraqitura në parashtrësën e ankueses nuk qëndrojnë, dhe janë shpifje të nivelit me të ultë, të cilat nuk janë vetëm ndaj tij por edhe ndaj paraardhësve të tij. Me tej thekson se me marrjen e detyrës është takuar me administratoren, shefen e zyrës së ZML-së – V., dhe shefen e SHP – L.S., dhe ka mbajtur një takim të përbashkët dhe ka kërkuar nga to bashkëpunim në mes tyre, të jenë të përgjegjshme, të respektojnë orarin e punës, detyrat e punës dhe t'i mbajnë të angazhuar të gjithë punonjësit e gjykatës. Arsye të këtij takimi kanë qenë raportet kolegjiale të tyre për faktin se administratorja ka pasur probleme të vazhdueshme me V. (për shkak të një procesi të caktuar) dhe kanë krijuar ndasi tek zyrtarët, nuk i kanë trajtuar në mënyrë të barabartë, i kanë diskriminuar të njëjtit, nuk i kanë vlerësuar, i kanë vlerësuar me tendencë etj. Raporte jo të mira administratorja ka pasur edhe me shefen tjetër L.S., të cilat i ka pas të njohura edhe si gjyqtarë por që i ka kuptuar me thellë kur i ka takuar të gjithë zyrtarët veç e veç të gjykatës dhe për këtë arsye është munduar t'i sanojë këto raporte njerëzore në rend të parë, e me pas edhe ato profesionale, dhe në këto pak muaj ka pas sukses me shumicën prej tyre por me administratoren siç duket nuk ia ka dalë. Me të njëjtën sa ka qenë gjyqtar nuk ka pas probleme dhe nuk ka pas kërkesë ndaj saj, por pas emërimit tim si kryetar ka konsideruar se për shkak të problemeve të vendit të punës me shefen e lartcekur dhe problemeve të vazhdueshme me kryetarin paraprak, me ushtruesin e detyrës së kryetarit ka menduar se duhen dhënë hapësirë të njëjtës që të punoj dhe kështu ka vepruar duke mos i ndërhyrë në asnjë kompetencë të saj. Pas gjashtë viteve si administratore e gjykatës për herë të parë me mua si kryetar i ka vizituar divizionet-shkrimoret e kësaj gjykate dhe nuk e ka pasur idenë se me çka merren zyrtarët në këto shkrimore, për herë të parë ka vizituar degët e kësaj gjykate, për herë të parë ka marrë pjesë në kolegjiun e gjyqtareve, për herë të parë ka dëgjuar për procedurat disiplinore të shërbyesve civil dhe ligjet dhe rregulloret e kësaj fushe. Për këtë periudhë kohore vazhdimisht ka kërkuar bashkëpunim nga e njëjta, të mos krijoj ndasi në mes të punonjësve dhe shefave përkatës por fatkeqësisht nuk ka hasur në mirëkuptim. Pa dashur të lëshohet në shpifjet e ngritura nga ana e saj thekson se kërkesa për të zbritur me zyrë në katin e parë ka qenë e tij për faktin se për gjashtë vite nuk është marrë me problemet e administratës, e meqë shefat përkatës gjinden në katin e parë (që duhet t'i raportojnë të njëjtës), gjithashtu administrata gjendet në katin e parë dhe zyra e financave ngjitur me zyrën e administratores, këtë e ka bërë që me qëllim që administrata të funksionoj me mirë, të respektohet arari, detyrat dhe vendi i punës (pasi që ka pasur zyrtarë që gjatë gjithë kohës kanë shkelur këto obligime dhe nuk kanë qenë përgjegjës) e assesi për ndonjë qëllim tjetër, e përveç kësaj ajo të njëjtën zyre e ka zgjedhur vetë, por niveli i saj është për keqardhje. Kurse, ankesa e të njëjtës është

bërë pasi që nuk ka dhënë mendim pozitiv për të në komisionin për vlerësimin e administratorëve, por mendim negativ për vazhdimin e punës së administratores (jo për arsye personale, por, për shkak që nuk ka dijeni profesionale, por as njerëzore për te qenë administratore), po ashtu ndaj të njëjtës ka iniciuar rast disiplinor e cila pas këtyre ngjarjeve fillimisht sëmuret e pastaj s'vjen në punë disa ditë dhe pastaj parashtron ankesë ndaj meje. Deklaratës ia ka bashkëngjitur këto dokumente: emaili-n e datës 30.06.2022; mendimin e dhen për komisionin datë 17.12.2022; kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore Agj.nr.421/22 , procesverbalet e datave 15.09.2022 dhe 19.09.2022, deklaratën e dhënë nga R.A., R. S., M.Sh., V.D., L.S., ankesat e A.A., vendimin e komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave KA.nr.32/21 datë 27.07.2021, emaili-n e anëtarit të komisionit E.V., datë 19.10.2022, vendimin e KPMSHCK A.nr.681/22 datë 14.09.2022 për F.A.

Pas analizimit të pretendimeve të ofruara nga parashtruesja e ankesës, deklaratës së kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan dhe provave të cilat ia ka bashkëngjitur deklaratës së tij, veçanërisht deklaratat e gjyqtareve dhe punëtorëve të gjykatës konsideroj se në rastin konkret nuk ka vend për të hapur rast disiplinore për këto arsye:

Se pari parashtruesja e ankesës të thënat në ankesë nuk i argumenton, në fakt edhe pse pretendimet në ankesë sa i përket shkëlqeve të cilat pretendon se janë kryer nga kryetari i gjykatës i ndan në ngjarje për asnjërin nga to nuk ofron asnjë provë qoftë materiale apo personale.

Së dyti, nga provat të cilat kryetari i Gjykatës ia ka bashkëngjitur deklaratës së tij sa i përket pretendimeve të parashtrueses së ankesës del se të thënat e saj janë të pabazuara.

Kështu, nga deklaratat e ish kryetarit të gjykatës R.A., rezulton se ky gjyqtar derisa ishte kryetar kishte probleme me administratoren, për shkak të mos punës së saj, përçarjes së kolektivitetit nga ana e saj, dhe, edhe për të kishte shkruar në Këshillë gjera të ndryshme nga ato me ulëtat që mund të ekzistojnë, për çka kishte bërë ankesa ndaj saj por pa sukses. Gjatë kohës së mandatit të tij ajo nuk kishte paraqitur ndonjë ankesë apo shqetësim ndaj ndonjë zyrtari të gjykatës. Kurse, rasti i qershorit të vitit 2019 është shpifje e ultë pasi që personalisht është marrë me atë rast. Në atë rast referenti Sh.H., kishte deklaruar se në kompjuterin e tij në regjistrin personal të tij ishin fshirë disa emra por shkresat dokumentet kishin qenë aty, por pasi që kishte kërkuar nga zyrtarët e IT-së ta verifikojnë këtë fakt dhe të shikonin kamerat ka rezultuar se askush nuk është futur në kompjuterin e tij dhe sipas zyrtareve të IT-së vet referenti gabimisht i kishte fshirë të njëjtat shënime që për gjykatën nuk kanë pas asnjë vlerë.

Nga deklaratat e gjyqtarës M.Sh., e cila gjatë vitit 2018 kishte qenë ushtruese e detyrës së kryetarit të gjykatës del se edhe kjo kishte pas probleme me parashtruesen e ankesës gjatë periudhës së ushtrimit të kësaj detyre. Gjatë kësaj periudhe nuk kishte bashkëpunim me parashtruesen e ankesës për shkak të mos punës, mos profesionalizimit, perceptimeve dhe shpifjeve të saj.

Edhe sipas deklaratës së nënkryetarit të gjykatës R.S., parashtruesja e ankesës është joprofessionale, nuk është punëtorë dhe në vazhdimësi krijon situata tendencioze me punëtorët administrativ dhe me gjyqtarë, dhe për të ka ankesa të vazhdueshme nga ana e punëtorëve administrativë.

L.S., shefe e shërbimeve të përbashkëta në gjykatën themelore në Gjilan në deklaratën e saj thekson se me parashtruesen e ankesës prej kohës kur është bërë administratore ka pas

probleme me të në vazhdimësi, dhe për të ishte ankuar edhe tek ish kryetari dhe kryetari i tanishëm, kurse ky i fundit kishte tentuar disa herë që të sanojë këto raporte. Sipas deklaruës këto raporte janë krijuar për shkak se e njëjta nuk është profesionale, është tendencioze, hakmarrëse dhe shpifëse. Si shefe e shkrimores në fund të muajit të qershorit apo korrikut të këtij viti në takim me kryetarin, administratoren dhe shefen tjetër V.D., ai i kishte njoftuar se kishte vendosur që administratorja dhe zyra e finance të vendosej në katin e parë. Pasi që i kanë bërë përgatitjet kishin zbritur poshtë dhe parashtruesja e ankesës – administratorja edhe pse e pakënaqur me vendimin e tij e kishte zgjedh zyrën vetë në të cilën do të vendosej dhe në cilën do të vendoseshin zyrtaret e financave.

Kurse, edhe V.D., shefe e zyrës qendrore për menaxhimin e lendeve në deklaratën e saj thekson se prej kohës që parashtruesja e ankesës është administratore e gjykatës ka pasur me të probleme të vazhdueshme pasi që ajo i ka përçarë gjithmonë punëtorët që i ka pasur në menaxhim të drejtpërdrejtë, duke krijuar raste të paqena, dhe duke shpifur. Sipas deklaruës ajo është e papërshtatshme për punë nuk i njeh procedurat e referentëve dhe punonjësve. Prej që është zgjedhur gjyqtari V.S., si kryetar i gjykatës për herë të parë ka shkuar në pushim vjetor pasi që gjithmonë ka pas problem me marrjen e pushimit nga ana e saj. Po ashtu kryetari i porsazgjedhur vazhdimisht ka bërë përpjekje që të sanohen këto raporte, të respektohet vendi dhe detyrat e punës.

Nga një gjendje e tillë e fakteve, si autoritet kompetent vlerësoj se pretendimet lidhur me shkeljet e bëra nga subjekti i hetimit -kryetari i gjykatës V.S., nuk janë të bazuara, andaj, në mungesë të fakteve të provuara mbi bazën e të cilave do të mund të kualifikohej ndonjë nga shkeljet e pretenduara konsideroj se nuk ka vend për fillimin e hetimeve disiplinore.

Andaj, nga arsyet e cekura në bazë të nenit 9 par. 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokuratorëve, dhe nenit 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 të Rregullores së KGJK-së, nr.05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Mejreme Memaj

U.D. Kryetare e Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
2. V.S., kryetar - Gjykata Themelore në Gjilan,
3. Parashtruesit të ankesës,
4. Arkivit të Gjykatës Supreme.